



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT
EUROPIAN PËRGJATË VITIT 2018**

- Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjvënës dhe kontrollues;

- Duke riafirmuar se objektivi strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin European, dhe me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave integrale;

- Duke riafirmuar mbështetjen e palëkundur për të respektuar vlerat mbi të cilat ndërtohet Bashkimi European dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe parimet e ekonomisë së tregut;

- Duke marrë në konsideratë faktin që gjithëpërfshirja dhe transparenca janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në procesin e integrimit european;

- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit european dhe përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit European dhe zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- Duke theksuar vendosmërinë tonë për krijimin dhe konsolidimin e një administrate publike efiçente, të aftë për të përballuar detyrimet e anëtarësimit, dhe forcimin e kapaciteteve të të gjitha grupeve të interesit;

- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integruar të vendit, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integrimit european;

- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit european;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Vlerësoi Raportin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian për vitin 2018 dhe rolin e tij në mbikëqyrje të progresit dhe përgatitjes për anëtarësim të arritur nga Shqipëria gjatë vitit 2018.

2. Përgëzon rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës mbi çështjet e integrimit europian dhe inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikëqyrje të reformave integruese të vendit dhe garantimit të gjithëpërfshirjes.

3. Vlerëson kontributin e vazhdueshëm të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian për fuqizimin e kapaciteteve administrative në çështjet e integrimit europian.

4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian dhe konkluzioneve të Këshillit Europian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit europian, si Komisioni i Integrimit Europian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian.

5. Shpreh vullnet të plotë për të ecur në rrugën e reformave në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile dhe reflektimin e tij në veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian përgjatë vitit 2019.

6. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe me organet shtetërore, anëtarë të përhershëm apo me statusin e të ftuarit në Këshill, me qëllim përmirësimin cilësor të monitorimit të procesit të integrimit europian.

7. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian të forcojë më tej rolin e tij si një forum kombëtar gjithëpërfshirës, cili nxit bashkëpunimin ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile dhe garanton transparencën për vendimmarrjen në çështjet e integrimit.

Miratuar në datën 30.5.2019